

Kontratë Kredie Specifike : L1056803

Sot, 01.03.2023, nga dhe ndërmjet:

IuteCredit Albania sh.a, regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me nr. NUIS: L42011023U, me seli në Rruga Andon Zako Cajupi, Ndertesë Nr.3, Hyrja 2, Tirana, përfaqësuar rregullisht nga Akan Ajdini në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv; (në vijim: **Kredidhënësi**); dhe

Besnik Paulin Bibaj, me numër identifikimi personal (PIN) J00307064M, numër Karte ID/Pasaporte 038031158, adresa Durres La. 15 Rr. Aleksander Goga Shpi Private Nr. 65 , adresë e-mail bibaj.besnikk@gmail.com, numër telefoni +355692186803 (në vijim: **Klienti**), në vijim bashkërisht të referuara si Palët dhe veçmas si Pala.

Në përputhje me Termat & Kushtet e Përgjithshme të Kredidhënësit dhe Kontratën Bazë nr. 881418222, Klienti kërkoi dhe Kredidhënësi i miratoi klientit një kredi sipas kushteve të mëposhtme:

KUSHTET KRYESORE	
Shuma e kredisë (LEK)	40 000 LEK
Periudha e kredisë (muaj)	24
Norma vjetore fikse e interesit	20,00 %
Komisioni i Angazhimit (%)	0,00 %
Komisioni i Procesimit (total) (%)	63,60 %
Komisioni i Administrimit të kredisë (mujore) (%)	0,00 %
Norma Efektive e Interesit (NEI) (%)	99,99 %
Shuma totale e pagesave të kryera nga Klienti për të shlyer kredinë dhe për të mbuluar koston e plotë të kredisë (LEK)	73 849 LEK

Palët bien dakord me vullnetin e tyre të lirë që Kredia të disbursohet për nevoja konsumi si më poshtë:

- 8 228 LEK do të perdoret për të ripaguar detyrimet monetare të Klientit perkundrejt Kredidhënesit sipas dakordesimit me Kontraten e Kredise Specifike nr. 780572.
- Diferenca e mbetur në shumën 31 772 LEK do të tërhiqet përmes një prej menyrave të tërheqjes të zgjedhur nga Klienti - transferet bankare, ATM, EasyPay, WesternUnion, Posta Shqiptare ose Raea. Në rast të tërheqjes së kredisë me anë të ATM klienti do të paguaje komisionin prej 3% të kredisë, shumë e cila zbritet nga Shuma e Kredise. Tërheqja e shumës së kredisë përmes EasyPay, WesternUnion, Posta Shqiptare mund të jetë subjekt i komisioneve për tërheqjen sipas Tarifës së cdo Ofruesi Sherbimi (kanali disursbimi).

Kredia do të shlyhet me këste në përputhje me Planin e Amortizimit, bashkangjitur si Shtojca 1 e kësaj Kontrate Kredie Specifike.

NDËRSA, nëse është e aplikueshme:

- Komisioni i Angazhimit llogaritet mbi shumën e kredisë dhe duhet të paguhet plotësisht në ditën e nënshkrimit të Kontratës së Kredisë Specifike dhe do të zbritet nga shuma e kredisë. Nëse Klienti ka paguar një tarifë aksesi dhe po ushtron të drejtën e tij për t'u tërhequr nga Kredia, Klienti do ta kthejë Kreditin në shumën që tejkalon Komisionin e Angazhimit.
- Komisioni i Procesimit llogaritet mbi shumën e kredisë dhe duhet të paguhet në ditën e nënshkrimit të Kontratës së Kredisë Specifike, megjithatë, palët bien dakord që Komisioni i Procesimit të paguhet së bashku me detyrimet mujore të kredisë, i ndarë në pjesë të barabarta sipas Grafikut të Pagesës, shtojcë e Kontratës së Kredisë Specifike. Për të shmangur dyshimet, tarifa e komisionit paguhet plotësisht edhe në rast të një shlyerjeje të parakohshme të kredisë ose përfundimit të parakohshëm të Kontratës për çfarëdo arsye.
- Komisioni i Administrimit llogaritet mbi shumën e kredisë dhe paguhet çdo muaj sipas Grafikut të Pagesës.

E drejta e tërheqjes 14-ditore:

Klienti ka të drejtë, pa paguar dëmshpërblim ose gjobë dhe pa dhënë arsye, të tërhiqet nga Kontrata e Kredisë Specifike brenda 14 ditëve nga data e nënshkrimit të Kontratës së Kredisë Specifike ose nga data në të cilën klienti merr informacionin për kushtet e Kontrates, siç përshkruhet në pikën 12 të Kontratës Bazë.

E drejta e shlyerjes së parakohshme:

Klienti do të ketë të drejtën të shlyejë kredinë plotësisht ose një pjesë të saj para kohe duke bërë një kërkesë për shlyerje të parakohshme të Kredidhënësi duke përdorur Mjetet e Qëndrueshme të Komunikimit siç thuhet në pikën 11 të Kontrata Baze. Vlera e aplikueshme e këtij komisioni publikohet në Tarife.

Njoftimet dhe Ndryshimet

Palët bien dakord se Kredidhënësi, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Kredimarrësit përmes mjeteve të qëndrueshme të komunikimit, të tilla si: (postë zyrtare, e-mail, telefonatë, sms, llogaria në web "My Iute" application) ka të drejtë të ndryshojë parashikimet e kësaj Kontrate. Në këto raste: a) Kredimarrësit do t'i mundesohet një afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike, brenda të cilit të mund të kundërshtojë me shkrim në një nga menyrat e qëndrueshme të komunikimit ndryshimin e njoftuar b) afati 15 ditësh sipas pikës a) me siper fillon të llogaritet nga data kur Kredidhënesi ka bërë njoftimin me një prej mjeteve të qëndrueshme të komunikimit c) ndryshimi i

njoftuar nga Huadhënësi nuk do të ketë efekt ndaj Huamarrësit përpara skadimit të një afati prej 15 (Pesëmbdhjete) Ditësh Kalendarike nga berja e njoftimit d) nqs klienti nuk ka shprehur kundërshtimi e tij sipas pikes a) ketu me siper, atehere Kredihenesi do te kuptoje qe Kredimarresi ka shprehur pelqimin e tij ne menyre te heshtur ne lidhje me ndryshimin.

Pasojat e pagesës me vonesë

Nëse Klienti nuk i përmbush plotësisht dhe në kohë detyrimet e tij sipas Kontratës së Kredisë Specifike, Kredihënësi ka të drejtat e mëposhtme:

- i. Të llogarisë Kamatëvonesën në rastin e pagesave të kësteve që paguhen në vonesë (pagesa në vonesë) në shlyerjen e detyrimeve. Kamatëvonesa llogaritet në përputhje me Kodin Civil dhe në masën e lejuar nga Banka e Shqipërisë. Interesi i aplikueshëm i pagesës së vonuar publikohet në Tarifë. Në datën e lidhjes së kësaj Kontrate Kredie Specifike, Kamatëvonesa është 1.5% (një pikë pesë për qind) në ditë e llogaritur mbi shumën e kredisë plus interesin e çdo detyrimi mujor me vonesë duke filluar nga dita pas datës kur detyrimi duhej të paguhej. Interesat e pagesës në vonesë (Kamatëvonesa), nuk kalojnë në asnjë rast më shumë se 30% të principalit së plus interesin e këstit/ve në vonesë.
- ii. Të llogarisë dhe ngarkojë Klientit një komision për njoftimet e detyrimeve të vonuara të dërguara me SMS nga dita e dytë e vonuar ne Shumen prej 25 Leke (njezete e pese leke) secili dhe komision për njoftimet me shkrim të dërguara si më poshtë: paralajmërimi i parë me shkrim 300 (treqind) Leke, paralajmërimi i dytë me shkrim 300 (treqind) Leke, paralajmërimi me shkrim përpara përfundimit të Kontratës së Kredisë Specifike 350 (treqind e pesëdhjete) Leke dhe njoftimin me shkrim për zgjidhjen e njëanshme të Kontratës nga Kredihënësi 350 (treqind e pesëdhjete) Leke, ndërsa kjo e fundit dënohet me penalitet ndepërje prej 30%.
- iii. Të ndër marrë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me ligjet në fuqi, duke përfshirë përfundimin e Kontratës së Kredisë Specifike dhe çdo kontrate tjetër të lidhur ndërmjet palëve dhe të kryejë të gjitha aktivitetet e nevojshme për mbledhjen e detyrimeve të saj përpara të gjitha autoriteteve dhe institucioneve kompetente, duke përfshirë por pa u kufizuar gjykatat, noterët, ekzekutorët dhe të tjerë.
- iv. Të raportojë në Regjistrin e Kredive informacionin mbi detyrimet e Klientit, të cilat mund të ndikojnë në besueshmërinë e klientit në të ardhmen. Të dhënat për klientin raportohen në Regjistrin e Kredive në bazë të akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Përfundimi i Kredisë në mënyrë të njëanshme nga Kredihënësi:

Në rast se Klienti ka ndonjë vonesë në pagesën e ndonjë prej detyrimeve të tij sipas Kontratës së Kredisë Specifike për më shumë se 50 (pesëdhjetë) ditë, Kredihënësi ka të drejtë të ndër presë Kontratën e Kredisë Specifike dhe/ose çdo kontrate tjetër në fuqi dhe të kërkojë nga Klienti të shlyejë menjëherë kredinë(të) e papaguara, interesin(et), komision(et), tarifat, kamatëvonesat, penalitetet dhe pretendimet e tjera që rrjedhin nga Kontrata e Kredisë Specifike dhe/ose ndonjë kontrate tjetër brenda 3 (tre) ditë pune nga marrja e një njoftimi përkatës nga Kredihënësi. Përfundimi i Kredisë në mënyrë të njëanshme nga Kredihënësi i nënshtrohet një gjobe përfundimi prej 30%.

Kjo Kontratë Kredie Specifike dhe shtojcat e saj janë pjesë përbërëse e Kontratës Bazë nr. 881418222. Termat e përdorur në këtë Kontratë Kredie Specifike do të kenë të njëjtin kuptim siç thuhet në Termat dhe Kushtet e Përgjithshme të Kredihënësit dhe Kontratën Bazë.

Me përjashtim të rasteve kur shprehimisht thuhet këtu, Palët kuptojnë dhe bien dakord që të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përshkuara në Kontratën Bazë nr. 881418222 do të zbatohen plotësisht në këtë Kontratë Kredie Specifike.

Kontrata e Kredisë Specifike do të hyjë në fuqi pas ekzekutimit të saj nga Palët. Kontrata e Kredisë Specifike është hartuar në gjuhën shqipe dhe nëse nuk është nënshkruar në mënyrë elektronike, është bërë në 2 kopje me vlefshmëri të barabartë, një për secilën palë. Nëse Kontrata e Kredisë Specifike lidhet në mënyrë elektronike, Palët kuptojnë dhe bien dakord të jenë të lidhura me detyrimet e ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit elektronik të dokumenteve, të cilat do të konsiderohen të barasvlefshme me nënshkrimin e bërë me dorë.

KREDIDHËNËSI:

luteCredit Albania sh.a

KLIENTI:

Besnik Paulin Bibaj

/ nënshkrimi /



.....
/ nënshkrimi /

Shtojca 1. Grafiku i Pagesave

Afati i kredisë	Data e Pagesës	Principali	Interesi	Komisioni i procesimit	Totali
1	16.03.2023	1 707 LEK	329 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
2	16.04.2023	1 386 LEK	650 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
3	16.05.2023	1 429 LEK	607 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
4	16.06.2023	1 433 LEK	603 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
5	16.07.2023	1 476 LEK	560 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
6	16.08.2023	1 483 LEK	553 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
7	16.09.2023	1 508 LEK	528 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
8	16.10.2023	1 550 LEK	486 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
9	16.11.2023	1 560 LEK	476 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
10	16.12.2023	1 601 LEK	435 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
11	16.01.2024	1 614 LEK	422 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
12	16.02.2024	1 641 LEK	395 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
13	16.03.2024	1 693 LEK	343 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
14	16.04.2024	1 698 LEK	338 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
15	16.05.2024	1 736 LEK	300 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
16	16.06.2024	1 756 LEK	280 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
17	16.07.2024	1 794 LEK	242 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
18	16.08.2024	1 816 LEK	220 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
19	16.09.2024	1 847 LEK	189 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
20	16.10.2024	1 884 LEK	152 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
21	16.11.2024	1 911 LEK	125 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
22	16.12.2024	1 946 LEK	90 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
23	16.01.2025	1 976 LEK	60 LEK	1 060 LEK	3 096 LEK
24	16.02.2025	1 555 LEK	26 LEK	1 060 LEK	2 641 LEK
Totali		40 000 LEK	8 409 LEK	25 440 LEK	73 849 LEK

Shtojca 2. Shembulli i përlogaritjes së NEI

Ne rast se shuma e kredise eshte 100,000 leke dhe afati i saj eshte 6 muaj atehere kesti mujor eshte 21,000 leke (i rrumbullakosur me perjashtim te kestit te fundit). Shuma totale qe klienti paguan ne fund eshte 125,961 leke bashke me interesat te cilat jane 4961 leke, bashke me komisionin e i cili eshte 18,000 leke dhe komisionin e administrimit qe eshte 3,000 leke.

Ekuacioni shnderrohet si ne vijim: $100,000 = 125,961 / (1+i)^{(6/12)} = 125,961 / (1+i)^{0.5}$;

$(1+i)^{0.5} = 125,961 / 100,000 = 1.25961$;

NEI = 127.8%

Shtojca 3. Shembulli i Përlogaritjes së Penaliteteve

Shuma e kredise 50,000 leke. Afati I kredise 12 muaj. Kesti i Kredise eshte 6200 leke. Principali dhe Interesi per cdo kest eshte 4558 leke. Në rast mos-pagimi të detyrimit mujor IuteCredit aplikon një penaltitet ditor prej 1.5 % të Principal dhe Interes (Ne rastin tone aplikohet mbi 4558 leke). Në rast vonese klientit i mbyllet kontrata ne ditën e 50-te te voneses. Ne rast mospagese do te kemi situaten e meposhtme:

1. Penaltiteti per kestin e pare ne vonese eshte 1367.4 leke (1.5% * 4558 leke* 20 dite vonese). Penaltiteti per kestin e dyte ne vonese eshte 1367.4 leke (1.5% * 4558 leke* 20 dite vonese).

2. Penaltiteti ne datën e mbylljes se kontrates eshte 30% te Principalit e te gjitha kesteve te ardhshme duke nisur nga data e mbylljes se kontrates. Principali i 10 kesteve te ardhshme nga data e mbylljes se kontrates eshte 42,228 leke * 30 % = 12668 leke.

3. Totali i penaltiteteve eshte 15,403 leke.

Shëmbulli i mësipërm është indikativ dhe ndryshon në varësi të shumës së disbursuar, ditën në të cilën terminon kontrata, kështu mujor të kredisë apo nëse kështu mujor paguhet i plotë apo i pjesshëm nga klienti. *Penaltiteti stopon kur shkon 30 % të Principalit dhe Interesit në vonese. Theksojme se klienti duhet të paguaje të gjithë detyrimin bashkë me penaltitetet e shtuara për shkak vonese , sepse

nëse nuk e paguan të plotë do të vazhdojnë të akumulohen penalitete mbi pjesen e papaguar të principalit dhe Interesit ; Edhe në këtë rast, të njëjtesa të pjesës *Penaliteti ditor vijon të llogaritet dhe stopon kur shkon 30 % të pjesës së mbetur të papaguar të Principalit dhe Interesit.

Shtojca 4. Shembulli dhe Metodologjia e Përlogaritjes së Këstit të Kredisë

Metodologjia dhe Shembulli i përlogaritjes së Këstit të kredisë

Huamarresi do të paguajë huane e marre (P), interesin, komisionin e procesimit (Kp) dhe komisionin e administrimit (Ka) në kështu në përputhje me Grafikon e Pagesave dhe kushtet në Kontraten Specifike të cilin terhiqet nga Huamarresi në çdo kohë pas disbursimit të kredisë.

Metoda dhe shembulli i llogaritjes së këstit të huasë jepet si vijon:

$$KK = P * (r * (1+r)^n / ((1+r)^n - 1) + (Kp * P) / n) + Ka / n * P$$

Shuma e kredisë (P) është 100 000 leke. Norma Vjetore e Interesit 17%, Norma Mujore e interesit (r) është 17%/12muaj = 1.42%; Numri i periudhave (n) = 12 muaj. Komisioni i procesimit (Kp) është 25 % e P-se ose 25,000 leke ; Komisioni i Administrimit (Ka) është 14.4% e P-se ose 14,400 leke . Kp dhe Ka ndahen në mënyrë të barabartë në 12 muaj. Kp/12 është 2083 leke. Ka/12 muaj është 1200 leke.

$$KK = P * r * (1+r)^n / ((1+r)^n - 1) + (Kp * P) / n + Ka / n * P = 100,000 \text{ leke} * 1,42\% * (1+1,42\%)^{12} / (1+1,42\%)^{12} - 1 + (25\% * 100,000 \text{ leke}) / 12 + (14.4\% / 12) * 100,000 \text{ leke} = 12,405 \text{ leke.}$$

*këstet në grafikun e pagesave janë të rrumbullkosura.

KREDIDHËNËSI:

IuteCredit Albania sh.a



/ nënshkrimi /



KLIENTI:

Besnik Paulin Bibaj

.....
/ nënshkrimi /

INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR I KREDISË KONSUMATORE

1. Emri dhe detajet e kontaktit të bankës	
Banka/Institucioni financiar i mikrokredisë Adresa Numri i telefonit Adresa e postës elektronike Adresa e web-it	IuteCredit Albania sha Rruga "Andon Zako Çajupi", Pallati Nr.3, Hyrja Nr.2, Kati 3, Tirana, Albania +355 44505060 info@iutecredit.al www.iutecredit.al
2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë	
<p>2.1 Lloji i kredisë Kjo është një kredi konsumatore e pasiguruar/siguruar (per rastin e kredive per makine). Klienti duhet te kete burim te sigurte te ardhurash dhe ketu perfshihen paga, te ardhurat nga biznesi. Iutecredit Albania financon nga 5.000 deri ne 500.000 LEK.</p> <p>2.2. Vlera totale e kredisë dhe monedha Kredia konsumatore levrohet vetem ne LEK. Shuma e kesaj kredie kredise eshte 73 849 LEK.</p> <p>2.3. Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve Kredia do të disbursohet me kërkesë të kredimarrësit në një shumë të vetme në një llogari bankare te vetë klientit, ne pikat e partnereve te ICA, në një prej ATM-ve të vendosura në dispozicion për këtë qëllim nga Huadheneesi, apo ne llogarine e percaktuar nga vete klienti ne rast se blihen te mira konsumatore te prekshme.</p> <p>2.4 Kohëzgjatja e kontratës së kesaj kredie: 24 muaj.</p>	<p>2.5 Këstet dhe kur është e mundur, mënyra se si do të shlyhen këstet Kesti per kredine eshte: 3 096 LEK. Plani i amortizimit te kredise (per cdo lloj kredie) eshte pjese integrale e kontrates specifike se firmosur.</p> <p>2.6 Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar Totali i koston së kredise per klientin perfshin: Shuma e fondeve te disbursuara + Shuma e Interesave; Komision administrimi, Komision Procesimi, Komision Angazhimi apo cdo komision tjetër te aplikueshem sipas zgjedhjes se klientit. Vlerat e seciles pjese se kostove jane te detajuara ne paragrafin 3.</p> <p>2.7. Nëse është e aplikueshme. Garanci/siguri të nevojshme Per kredite konsumatore te pasiguruara, nuk kerkohej garanci/kolateral hipotekor apo bashkepergjegjes. Per kredite konsumatore te siguruara, te llojit "kredi per makine", kerkohej garanci/kolateral, e llojit mjet motorrik.</p>
3. Kostoja e kredisë	
<p>3.1. Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë Klienti do te paguaje interes dhe komisione mbi shumen e disbursuar dhe te pashlyer te kredise, perfshire Komisionin e terheqjes ne ATM (nese eshte i zbatueshem). Interesi per kete kredi eshte: 20,00 %.</p> <p>3.2 Norma efektive e interesit (NEI) Ështe norma efektive e interesit e llogaritur si mesatare e normës efektive të interesit të aplikuar nga subjektet sipas llojit të kredisë konsumatore, duke konsideruar/shtuar edhe një të tretën e saj sic përcaktohet në rregulloren e Bankës se Shqipërisë për Kredine Konsumatore dhe Hipotekare, të ndryshuar. Kjo normë vendoset në fund të cdo gjashtëmuajori për gjashtëmuajorin vijues nga Banka e Shqipërisë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit. Norma efektive e interesit per kete kredi eshte 99,99 %.</p> <p>3.3 A është e mundur të përfitohet kredia sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, duke përfshirë: kontratat e sigurimit për kredinë? Kredia konsumatore (e siguruar/e pasiguar) ne IuteCredit Albania sha perfitohet pa nenshkrim te kontratave te sigurimit.</p> <p>3.4 Kosto të tjera të lidhura me kredinë Nuk ka.</p> <p>3.5 Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë: Komisione: Komisioni i procesimit per kete kredi eshte: 25 440 LEK. Komisioni i Angazhimit per kete kredi eshte 0 LEK. Nese klienti zgjedh kanalin e disbursimit te ATM Komisioni i terheqjes ne ATM eshte 3% e shumes qe do te terhiqet.</p>	<p>3.6 Shuma e kostove për përdorim të caktuar të një pagese: Nuk ka.</p> <p>3.7 Ndonjë kosto tjetër që rrjedh nga kontrata e kredisë: Nuk ka.</p> <p>3.8 Kushtet, sipas të cilave koston e sipërpërmendura që kanë të bëjnë me kontratën e kredisë mund të ndryshojnë Nuk ka kushte shtese te cilat mund te sjellin ndryshimin e kontrates sipas kostove te larte permendura.</p> <p>3.9 Detyrimi për të paguar shpenzimet noteriale Nuk ka shpenzime noteriale.</p> <p>3.10 Kostot në rastin e pagesave me vonesë Penalitetet ne rast vonese pagese qe paguhen nga Huamarrresi jane + 1.5% në ditë e llogaritur mbi shumen e principalit plus interesin e cdo kesti ne vonese duke nisur nga e nesermja e dates kur detyrimi është bërë i kërkueshëm dhe gjithashtu kosto shtese prej Leke 300 per dy letrat e para te njoftimit dhe 350 leke per letrën e tretë dhe te katert te njoftimit qe do te dergohen ne adresen e dhene nga klienti si dhe nje kosto shtese prej Leke 25 per njoftimin me sms per vonesat. Ne rast se Huamarrësi nuk shlyen detyrimet e tij sipas Kontratë, për më shumë se 50 (pesëdhjetë) ditë kalendarike per llogaritjen nga data e ripagimit te kstit sipas kontrates, atehere Kredimarrësi Huadhënësi deklaroi menjëherë shumën totale të detyrimit dhe njoftoi Huamarrësin për zgjidhjen e Kontratës në mënyrë të njëanshme. Penaliteti që Huamarrësi detyrohet t'i paguajë Huadhënësit për zgjidhjen e kontrates ne menyre te njehanshme është në masën 30% te principalit të papaguar ne ditën e terminimit. Penaliteti ne datën e mbylljes se kontrates eshte 30% te Principalit e te gjitha kesteve te ardhshme duke nisur nga data e mbylljes se kontrates.</p>
4. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore	
<p>4.1. E drejta e tërheqjes: Huamarrësi ka të drejtë të tërhiqet nga një hua e lidhur sipas kushteve të Kontratës, brenda një periudhe kalendarike 14 (katërmëdhjetë) ditore nga data e lidhjes së saj, pa dhënë arsye për këtë. Tërheqja nga Kontrata do të hyjë në fuqi vetëm nëse Huamarrësi brenda të njëjtit afat 14 ditor, i paguan Huadhënësit shumën e plotë dhe të saktë të detyrimeve sipas njoftimit të Huadhënësit. Në rast të kundërt, Huamarrësi pranon se tërheqja nuk është e vlefshme, se kontrata e huasë mbetet në fuqi dhe se ai detyrohet të përmbushë kontratën e huasë në përputhje me kushtet e saj.</p> <p>4.2 Shlyerja (pagesa) e kredisë para afatit të maturimit Klienti ka te drejten te parapaguaje te gjithen ose nje pjese te shumes se principalit te kredise se papaguar deri ne ate kohe, plus interesin e arritur deri ne datën e parapagimit</p> <p>4.3 Institucioni ka të drejtën e kompensimit, në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit. Nese klienti e mbyll kredine perpara kohe eshte i detyruar te paguaje te gjithë komisionin e rene dakort sipas tarifes ne fuqi</p> <p>4.4 Informimi në rast refuzimi të kredisë Banka do të informojë konsumatorin, menjëherë pa komisione, nëse një aplikim për kredi është refuzuar, duke i vënë në dispozicion arsyet mbi të cilat është bazuar ky refuzim.</p>	<p>4.5 Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit në rastin e ndryshimeve të kushteve, të cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës Çdo njoftim, kerkese ose komunikim me klientin do te behet me mjete te qendrushme te komunikimit. Në këto raste, (i) ndryshimi i njoftuar nga Huadhënësi nuk do të ketë efekt ndaj Huamarrësit përpara skadimit të një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e njoftimit të Huadhënësit, dhe (ii) gjatë këtij afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) Ditësh Kalendarike, Huamarrësi ka të drejtë t'i njoftojë Huadhënësit zgjidhjen e Kontratës, nëse nuk është dakord me ndryshimin e propozuar. Nëse Huamarrësi nuk i paraqet Huadhënësit një njoftim zgjidhje Kontrate brenda afatit të cituar më sipër, atëherë ndryshimet e njoftuara nga Huadhënësi, do të fillojnë të zbatohen duke nisur nga përfundimi i afatit prej 15 ditësh kalendarike.</p> <p>4.6 Skema e brendshme e ankimit të konsumatorit kundrejt bankës Klientet mund te paraqesin ankese ne tre menyra komunikimi: - me shkrim pane cdo dege te IuteCreditAlbania sha; - nepermejet adreses elektronike: info@iutecredit.al - duke telefonuar ne +35544505060 (e hene-e diele 08:00–20:30)</p> <p>4.7 Periudha kohore gjatë së cilës Banka ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor. Ky informacion është i vlefshëm prej datës 01.03.2023 deri në datën 08.03.2023.</p>

KONTRATË BAZE PER KREDI KONSUMATORE : 881418222

Sot, 01.03.2023, nga dhe ndërmjet:

1. PALËT

KREDIDHËNËSI	
Emri	IuteCredit Albania sh.a
Numri i regjistrimit	L42011023U
Adresa	Rruga "Andon Z. Cajupi", Ndërtesa Nr. 3, Hyrja Nr. 2, Kati i Tretë
E-mail	info@iutecredit.al
Faqe interneti	https://iutecredit.al/
Numër telefoni	044 50 50 60
Emri i përfaqësuesit	Akan Ajdini

KLIENTI	
Emri	Besnik Paulin Bibaj
PIN/LNC	J00307064M
Nr Karte ID/Pasaporte	038031158
Adresa	Durres La. 15 Rr. Aleksander Goga Shpi Private Nr. 65
E-mail	bibaj.besnik@gmail.com
Numër telefoni	+355692186803

2. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

2.1. Termat dhe Kushtet e përshkruara në këtë kontratë bazë (në tekstin e mëtejshëm: Kontrata Bazë), si dhe termat dhe kushtet e të gjitha dokumenteve të renditura në pikën 2.3. të kësaj Kontrate Bazë, përbëjnë mirëkuptimin e plotë të Palëve për të lidhur Kontratën e Kredisë Konsumatore (në tekstin e mëtejshëm: Kontrata).

2.2. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në mënyrë specifike në këtë Kontratë Bazë, termat me shkronjë të madhe të përdorur këtu do të kenë kuptimin e përcaktuar në Termat dhe Kushtet e Përgjithshme ("Termat dhe Kushtet e Përgjithshme") të Kredidhënsit.

2.3. Çdo Marreveshje përbëhet nga:

2.3.1. Termat dhe Kushtet e Përgjithshme;

2.3.2. kjo Kontratë Baze;

2.3.3. Kontrata e Kredisë Specifike;

2.3.4. Tarifa;

2.3.5. Njoftimi i Politikës së Privatësisë;

2.3.6. Klauzola e pelqimit paraprak;

2.3.7. nëse është e aplikueshme, të gjitha kontratat e tjera, mirëkuptimet e ndërsjella dhe të gjitha anekset e çdo kontrate të lidhur ndërmjet Palëve (duke përfshirë çdo ndryshim dhe plotësim).

2.4. Klienti e kupton dhe pranon që Termat dhe Kushtet e Përgjithshme, Tarifa dhe njoftimi i Politikës së Privatësisë, janë subjekt i ndryshimeve herë pas here sipas gjykimit të vetëm të Kredidhënsit dhe janë të disponueshme në faqen e internetit të Kredidhënsit www.iutecredit.al.

3. AFATI

3.1. Kontrata Bazë do të hyjë në fuqi pas ekzekutimit të saj nga Palët dhe do të qëndrojë në fuqi për një periudhë të pacaktuar deri në përfundimin në përputhje me Kontratën. Për shmangien e dyshimit dhe nëse nuk është rënë dakord ndryshe, përmbushja e plotë e detyrimeve të Klientit sipas ndonjë dhe të gjitha Kontratave të Kredisë Specifike nuk do të përfundojë Kontratën Bazë ose kontrata të tjera të lidhura ndërmjet Palëve.

4. OBJEKTI I KONTRATËS BAZË

4.1. Bazuar në këtë Kontratë Bazë, Kredidhënsi do të:

4.1.1. hapë për klientin një llogari klienti (në tekstin e mëtejshëm: Llogaria) në të cilën klienti mund të hyjë në platformën MyIute;

4.1.2. japë kredi Klientit sipas kontratës (ave);

4.1.3. t'i vendosë Klientit një kufi personal kredie (në tekstin e mëtejshëm: PCL; i referuar gjithashtu si kufi i miratuar personal, PAL), madhësia e të cilit do të varet nga vlerësimi i besueshmërisë dhe përballueshmërisë të kryer herë pas here nga Kredidhënsi sipas gjykimit të tij, dhe t'i japë Klientit kredi sipas Kontratës (ave) brenda PCL-së me termat dhe kushtet e përshkruara në këtë Kontratë Bazë;

4.1.4. vendosë në dispozicion shërbime shtesë të lidhura me Kontratën.

5. LLOGARIA E KLIENTIT

5.1. Llogaria është e aksesueshme për Klientin në faqen e internetit www.iutecredit.al dhe në aplikacionin MyIute.

5.2. Hyrja në llogari do t'i nënshtrohet vërtetimit të klientit, ku identiteti i klientit konfirmohet përmes mjeteve dhe zgjidhjeve teknike (në tekstin e mëtejshëm: Elementet e Sigurisë).

5.3. Për përdorimin e Llogarisë, mjetet dhe lidhjet e Klientit duhet të jenë në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara nga Kredidhënsi. Kërkesat përshkruhen në Termat dhe Kushtet e Përgjithshme.

5.4. Klienti do të ruajë me kujdes Elementet e Sigurisë dhe do të ndërmarrë çdo hap për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e Elementeve të Sigurisë.

5.5. Klienti do të njoftojë menjëherë Kredidhënësin për humbjen ose vjedhjen e Elementeve të Sigurisë ose për humbjen e zotërimeve të tyre kundër vullnetit të klientit në çdo mënyrë tjetër. Nëse Kredidhënësi merr një njoftim të tillë, Kredidhënësi do të marrë masa për të parandaluar përdorimin e Llogarisë.

5.6. Pa qenë i detyruar të kompensojë ndonjë dëm të mundshëm, Kredidhënësi ka të drejtë të refuzojë aksesin në llogari ose miratimin e çdo kërkesë të bërë në të, nëse Elementet e Sigurisë janë përdorur gabimisht ose nëse Kredidhënësi ka dyshime për vërtetësinë e identitetit të Klientit.

5.7. Llogaria mund të përdoret për të aplikuar për kredi, për të filluar disbursimin e kredisë nëpërmjet kanalit të preferuar, për të parë balancat aktuale të kredive të tyre dhe shlyerjet e tyre ndaj Kredidhënësit, Grafikut të Pagesave të Kontratave Aktive të Kredisë Specifike, për të filluar shlyerjet (përfshirë shlyerjet e hershme), për të aplikuar për pezullime dhe shërbime të tjera shtesë siç vihen në dispozicion nga Kredidhënësi dhe çdo funksionalitet tjetër që i vihet në dispozicion Klientit tani ose në të ardhmen. Për të shmangur dyshimet, Llogaria nuk konsiderohet si një llogari e hapur dhe e mbajtur nga një institucion pagese që vepron sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

5.8. Klienti pranon dhe bie dakord që çdo kërkesë e bërë nga Klienti në llogarinë e tij do të jetë detyruese dhe në rast të kërkimit të shërbimeve shtesë që përfshijnë kosto shtesë, Klienti pranon të paguajë kostot sipas Tarifës së aplikueshme në momentin e bërjes së kërkesës. Me kërkesën e Kredidhënësit, Klientit mund t'i duhet të konfirmojë disa kërkesa duke përdorur një Element Sigurie shtesë ose në një mënyrë tjetër të rënë dakord me Kredidhënësin. Një konfirmim i tillë do të konsiderohet si pëlqim i Klientit për përbushjen e kërkesës. Për të shmangur dyshimin, çdo dhe të gjitha Kontratat e Kredisë Specifike do të duhet të nënshkruhen veçmas (fizikisht ose elektronikisht) siç përshkruhet në Termat dhe Kushtet e Përgjithshme, pavarësisht nëse kërkesa për kredi është nisur nga Klienti në llogarinë e tij.

5.9. Në rast se Klienti ka bërë pagesa ndaj Kredidhënësit të cilat tejkalojnë shumat e duhura (mbipagesë), ajo do t'i vizualizohet Klientit si një bilanc pozitiv në llogarinë e tij. Nëse Klienti ka një bilanc të tillë pozitiv në llogarinë e tij, Kredidhënësi rezervon të drejtën të shlyejë shumat me çdo dhe të gjitha pretendimet që Kredidhënësi mund të ketë ndaj klientit që rrjedhin nga Kontrata(at) e tjera të Kredisë ose kërkesat e miratuara të Klientit, duke pasur parasysh se pretendime të tilla janë të rregullta.

6. LIMITI PERSONAL I KREDISË

6.1. Kredidhënësi do të krijojë PCL-në e Klientit bazuar në Vlerësimin, i cili do të kryhet herë pas here sipas gjykimit të Kredidhënësit sipas rregullave të brendshme të Kredidhënësit dhe ligjeve në fuqi, brenda të cilave Klienti mund të aplikojë për kredi nga Kredidhënësi.

6.2. Kredidhënësi rezervon të drejtën të refuzojë dhënien e Kredisë(ve) brenda PCL-së.

6.3. Klienti mund të shohë PCL-në aktuale të vendosur në llogarinë e tij ose të informohet për të duke kontaktuar Kredidhënësin.

7. TERMAT E PËRGJITHSHME TË KREDIDHËNIES

7.1. Kredidhënësi është i detyruar:

7.1.1. t'i japë Klientit informacionin parakontraktor dhe kontraktor në lidhje me Kredinë e kërkuar në përputhje me ligjet në fuqi;

7.1.2. pasi të lidhet Kontrata e Kredisë Specifike, t'i disbursojë Klientit Kredinë në shumën dhe kohën, dhe nëpërmjet kanaleve të preferuara siç kërkohet nga Klienti, me përjashtim të rasteve të përshkruara në Termat & Kushtet e Përgjithshme dhe këtu;

7.1.2.1. kur lidh ndonjë Kontratë Kredie Specifike për blerjen e shërbimeve dhe/ose mallrave të disbursojë kredinë e miratuar në llogarinë bankare të Ndërmjetësit të Kredisë. Ekzekutimi i pagesës në llogarinë e Ndërmjetësit të Kredisë përbën përbushjen e detyrimit të Kredidhënësit për t'i dhënë Klientit Kredinë;

7.1.2.2. kur Kontrata e Kredisë Specifike është për shlyerjen e një detyrimi monetar ekzistues të Klientit ndaj Kredidhënësit ose një Kredidhënësi tjetër, të disbursojë shumat ndaj Kredidhënësit ose Kredidhënësit tjetër, në këtë rast data e disbursimit të kredisë është data e nënshkrimit të Kontratës së Kredisë Specifike. Në rast se shuma e kredisë sipas Kontratës së Kredisë Specifike është më e madhe se shuma e detyrimeve të Klientit ndaj Kredidhënësit ose Kredidhënësit tjetër, shuma e mbetur e kredisë, e dhënë sipas Kontratës së Kredisë Specifike, do të disbursohet nga çdo metodë e disponueshme e zgjedhur nga Klienti.

7.1.3. të regjistrojë në kohë dhe me saktësi këstet e shlyera të kredisë nga Klienti dhe, nëse kërkohet nga Klienti, të japë informacion të plotë dhe të saktë për shlyerjet e kryera dhe të regjistruara deri në ditën e kërkesës.

7.2. Kredidhënësi ka të drejtë:

7.2.1. të kërkojë shlyerjen e plotë të të gjitha detyrimeve të papaguara të Klientit sipas Kontratës;

7.2.2. Me diskrecionin e vetë Kredidhënësit, të shpërndajë shumën e paguar nga Klienti në llogarinë e tij, duke zgjedhur se për cilën Kontratë do të aplikojë së pari pagesën në rast të Kontratave të Kredisë Specifike aktive paralele ose të zgjedhë cilin nga detyrimet e Klientit të shlyejë së pari në rast të fondeve të pamjaftueshme, përveç nëse Klienti ka dhënë udhëzime specifike;

7.2.3. kërkojë nga Klienti çdo dokument të nevojshëm, d.m.th. kopje të dokumenteve për miratimin e Kontratave të Kredisë Specifike;

7.2.4. me diskrecionin e vetë Kredidhënësit të mbajë, përfshirë nëpërmjet palëve të treta, çdo korrespondencë me Klientin, të kryejë biseda telefonike me Klientin, të dërgojë mesazhe dhe letra elektronike në rast se Klienti nuk përbush asnjë nga detyrimet që rrjedhin nga Kontrata dhe në këtë mënyrë ta informojë atë për vonesa të tilla dhe Klienti jep konfirmimin e tij të pakushtëzuar me nënshkrimin e kësaj Kontrate;

7.2.5. në rast të vonesës në shlyerjen e detyrimeve të duhura nga Klienti, si dhe në rast të shlyerjes së pjesshme të detyrimeve mujore, të ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme për mbledhjen jashtëgjyqësore dhe/ose të detyruar të arkëtimeve të tij, rast në të cilin shpenzimet do të barten nga Klienti.

